




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <b>2-D/DPK</b>	Nr. Prot. Br. Prot. <b>01-2524/13</b>
Nr. l. faq. Broj. stranica <b>02</b>	Data Datum <b>26.08.2013</b>
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.08.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-454/13, për zyrtarin e lartë z. Isa Derguti, Menaxher i Kontabilitetit në Ndërmarrjen Publike "Trainkos"Sh.A, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-454/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Isa Derguti, Menaxher i Kontabilitetit në Ndërmarrjen Publike "Trainkos"Sh.A, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron pozitën e personit të autorizuar në bizneset private "KONTOWEB"Sh.p.k dhe "ON"SH.P.K

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 07.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Isa Derguti, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Derguti me datën 14.04.2013, për shkak se ka qenë në udhëtim jashtë vendit, gjatë takimit i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se

ushtron funksionin e Menaxher i Kontabilitetit në Ndërmarrjen Publike "Trainkos"Sh.A dhe është i regjistruar si person i autorizuar dhe pronare në bizneset private "KONTOWEB"Sh.p.k dhe "ON"SH.P.K

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se do te mundohet qe në afat sa me te shpejtë do te bëjë ndryshimet dhe do të japë dorëheqje nga pozita e personit te autorizuar dhe do ta shmangë çfarëdo situatë qe mundë te shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë z.Isa Derguti, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se është tërhequr nga te qënurit person i autorizuar i Kompaninë në fjalë.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z.Isa Derguti, konstatojmë se : zyrtari i lartë z.Isa Derguti, menaxher i kontabilitetit në ndërmarrjen publike "Trainkos"Sh.A, ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit te interesit në te cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

